

REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIA PRITIV KORUPCIE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. / Dep. / Dep.	Nr. Prot. / Si Prot. / Prot. No.
D-P	03-2722/11
Nr. Gaj. / Nr. Gaj. / Nr. Gaj.	Udh. / Udh. / Udh.
01	13-05-2011
Nr. pages. / Nr. pages. / Nr. pages.	Date / Date / Date.

Nr.regj. 16928/2010

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Haqif Mulliqi nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 6.2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195,199 dhe 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 14.04.2011 merr këtë:

AKTVE N D I M

PEZULLOHET: Procedura kundërvajtëse ndaj Haqif (Shahin) Mulliqi, i lindur në vitin 1960 në Pejë, tani me vendbanim në Prishtinë, në rrugën "Bill Clinton", Blloku 5, E- 2 nr.1, i martuar, Doktor i Filologjisë, Profesor në Fakultetin e Arteve dhe Prodekan i Degës së Artit Dramatik, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, për kundërvajtjen nga neni 6.2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik.

Pezullimi bëhet komfor nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet për shkak se nuk ka prova se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palës dhe parashtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë, i parashtrroi kësaj gjykate kërkesën 01/2312/2010 me datë 15.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj Haqif Mulliqi për kundërvajtjen nga neni 16 paragrafi 1.pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, me përshkrim se i njëjti në Agjencinë Kundër Korrupsion nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë deri më datën 31 mars 2010.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje Haqif Mulliqin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se nuk ndihet aspak përgjegjës për këtë kundërvajtje sepse prej datës 25.03.2010 deri më 04.04. 2010 ka qenë në një udhëtim në Jordani për çka i prezanton gjyqtarës edhe kopjen e pasaportës së tij. Në vazhdim shton se për mungesën e tij gjatë periudhës së shënuar, ka njoftuar sekretarin e fakultetit. Si arsyetim tjetër Haqif Mulliqi jep edhe faktin se nuk e ka bërë deklarin e gjendjes së pasurisë për shkak se fillimisht nuk ka qenë fare i informuar se pozita që mban e obligon atë të deklarojë gjendjen e pasurisë.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë faktike, gjyqtarja dëgjoi edhe parashtruesin e kërkesës, në cilësi të dëshmitarit i cili me kopje të korrespondencës elektronike dëshmoi se Menaxheri i Personelit të Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, me datë 22.03.2011, i kishte dërguar Agjencisë listën e zyrtarëve të lartë të cilët duhej të deklaronin pasurinë, e më pas me datë 25.03.2011, në ora 08:06 i kishte dërguar gjithë sekretarëve të fakulteteve njoftimin se, çdo zyrtarë i lartë në secilin fakultet sipas titujve, është i obliguar të bëjë deklarin e pasurisë, gjithashtu kishte shënuar edhe afatin e fundit për këtë deklarin si dhe kishte bashkangjitur formularin për plotësim dhe njoftimin se duhet dorëzuar personalisht në Agjencinë Kundër Korrupsion, kurse në ora 11:10 i njëjti sërish kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës se njoftimin me informatat e duhura e kishte shpërndarë gjithë sekretarëve të fakulteteve. Dëshmitari në vazhdim thekson se nuk ka qenë personalisht i njoftuar për mungesën e Haqif Mulliqit, por nuk e përjashton mundësinë se dikush tjetër nga Agjencia mund të ketë qenë i njoftuar.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së Haqif Mulliqit, deklaratës së dëshmitarit nga Agjencia Kundër Korrupsion, shqyrtimi i shkresave të tjera të lëndës e posaçërisht nga administrimi i provave

materiale të prezantuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, si vulat në pasaportë të Haqif Mulliqit dhe korrespondenca zyrtare midis zyrtarëve të Agjencisë dhe Rektoratit, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi se Haqif Mulliqi me datë 25.03.2011, ditën kur sekretarët e fakulteteve ishin njoftuar me çështjen e formularëve të Agjencisë, vërtetë kishte udhëtuar për në Jordani ku ka qëndruar deri më datë 03.04.2011, e që shihet nga vula në pasaportë të Haqif Mulliqit dhe është fare e kuptueshme se me datë 25.03.2010 derisa kishte për të udhëtuar, ai ka mundur fare të mos ketë shkuar në vendin e tij të punës. Ndërsa deklarates se nuk e ka ditur se s'bari pozitë e caktuar obligon të bëjë deklaratim e pastërtisë gjyqtarja nuk ia lall besimin, ngase secili zyrtar kur merr pozitën përkatëse është i obliguar të profitohet me obligimet e tjera që dalin sipas ligjit, mirëpo në rastin në fjalë është irrelevante. Andaj, gjyqtarja pas vlerësimit të përgjithshëm të lëndës, konstatoi se nuk ekziston prova se i pandehuri ka kryer kundërvajtje dhe në vështrim të nenit 198 par. 1 pika 8 të LK, ndaj Haqif Mulliqit e PEZULLOI procedurën kundërvajtëse.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Nr. Regj. 16928/2010, datë 14.04.2011

Gjyqtarja
Suzana Cerišni

KESHILLA E KESHILLARIT kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Partit për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, në faks.

